

Platforma për analizë dhe hulumtime



Qëndrimet e qytetarëve në veri të Kosovës

Aspektet politike, ekonomike dhe të sigurisë





Kontraktuesit e hulumtimeve:

Platforma për analizë dhe hulumtime

OJQ AKTIV dhe Qendëra për Paqe dhe Tolerancë

Autorët e hulumtimeve:

MA Nikola Jović

MA Branislav Nešović

Për botuesin:

OJQ AKTIV

Kralja Petra I, 183a, Mitrovica e veriut

email: office@ngoaktiv.org

www.ngoaktiv.org

Rezerva:

Ky raport është hartuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Europian në Kosovë.

Për pikëpamjet e shprehura në këtë raport është përgjegjës vetëm OJQ „AKTIV-a“ dhe „Qendëra për Paqe dhe Tolerancë“ dhe këto pikëpamje në asnjë mënyrë nuk mund të trajtohen si qëndrime të Bashkimit Europian.

Mitrovica veriore,

Shtator 2015.



Përmbajtja

▣ Konteksti i hulumtimeve.....	5
▣ Metodologjia e hulumtimeve	7
▣ Rezultatet më të rëndësishme	8
▣ Përmbledhje e hulumtimeve: Perceptimi i çështjeve kyçe	9
▣ Qëndrimet e qytetarëve mbi situatën politike në Kosovë	12
▣ Qëndrimet e qytetarëve mbi situatën ekonomike në Kosovë....	22
▣ Qëndrimet e qytetarëve mbi situatën e sigurisë në Kosovë	30
▣ Qëndrimet e qytetarëve mbi të drejtat dhe lirit në Kosovë.....	40
▣ Konkluzionet	45



Lista e shkurtesave

UNMIK - United Nations Interim Administration Mission in Kosovo/ Misioni i përkohëshëm administrative i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

UNDP - *United Nations Development Programme*/Programi i Kombeve të Bashkuara për zhvillimj

EULEX - European Union Rule of Law Mission in Kosovo/ Misioni për sundimin e ligjit e Bashkimit Evropian në Kosovë

OVK - **UÇK**, Ushtria Çlirimtare e Kosovës

KZK -**TMK**, Trupat Mbrojtëse të Kosovës

KPS -**SHPK**, Shërbimi Policor i Kosovës

DS -**PD**, Partia Demokratike

DSS - **PDS**, Partia Demokratike e Serbisë

MUP - **MPB**, Ministria e punëve të brendëshme e Serbisë (Republikës së Serbisë)

ZSO - **AKS**, Asociacioni i Komunave Serbe

NATO - North Atlantic Treaty Organisation/ Aleanca e marrëveshjes së Atlantikut të Veriut

APR -**ARE**, Agjensioni për Regjistrime Ekonomike

CZ - **MC**, Mbrojtja Civile

KFOR - Kosovo Force - Forcat e KFOR-it në Kosovë

USAID - United States Agency for International Development-Agjensioni i Shteteve të bashkuara për ndihmë ndërlombëtar

IBM - **MIK**, Menaxhimi i integruar i kalimeve



Konteksti i hulumtimeve

Platforma për analizë dhe hulumtime në kuadër të projektit për "Forcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile për të kontribuar në mënyrë më efektive në procesin e vendimmarrjes" ka kryer hulumtime mbi qëndrimet e qytetarëve në katër komuna më të mëdha serbe në veri të Kosovës (Mitrovica veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan). Qëllimi i hulumtimeve ka qenë që të kuptohen pikëpamjet e qytetarëve mbi çështjet kyçe politike, ekonomike dhe të sigurisë, por edhe për të fituar njohuri mbi problemet kryesore me të cilat ballafaqohen qytetarët në veri të Kosovës. Prej hulumtimeve të bëra, kemi mësuar se çfarë mendojnë qytetarët për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë, gjendjen socio-ekonomike, pjesëmarrjen e serbëve në procese politike në Kosovë dhe mbi respektimin e të drejtave të njeriut.

Hulumtimet janë kryer ndërmjet muajit maj dhe korrik të vitit 2015. Kjo periudhë është shënuar me lajme për vazhdimin e negociatave në Bruksel mes qeverive në Beograd dhe Prishtinë, rritjes së interesit për realizimin e elementeve bazë të marrëveshjeve të nënshkruara, siç është Asociacioni i Komunave Serbe, si dhe integrimi e pjesëtarëve të Mbrotjtjes Civile në institucionet e Kosovës. Përveç bisedimeve të vazhdueshme në Bruksel, tema të tjera që kanë preokupuar vëmendjen e qytetarëve në këtë periudhë ishin incidentet etnikisht të motivuara në veri të Mitrovicës, si dhe diskutimet në Kuvendin e Kosovës për formimin e Gjykatës Speciale për Krime të Luftës të UÇK-së.

Për sa i përket Marrëveshjes në Brukselit, ajo shënoi një ndryshim paradigme në marrëdhëniet midis Beogradit dhe Prishtinës. "Status quo", që ka ekzistuar prej kohësh në veri të Kosovës filloi të shkrihet me bisedime të rëndësishme që pasuan. Megjithatë, palët negociuese kanë përdorur, dhe ende përdorin, marrëveshjen "konstruktive" me dykuptimësi për të interpretuar atë sipas interesave të tyre dhe të dedikojnë për elektoratin e tyre dhe publikun vendor. Në tërësi këtë proces qytetarët nga veriu i Kosovës nuk kishin mundësi për të ndikuar në marrëveshjet e arritura dhe në zbatimin e tyre. Qytetarët në veri të Kosovës, Marrëveshjen në Brukselit shihnin si të padëshirueshëm dhe si një koncesion të imponuar ndaj Prishtinës nga ana e Beogradit. Përveç kësaj, në momentin e arritjes së marrëveshjes, te popullata, për shkak të paqartësive dhe dukuptimësive, dukshëm u krijua pakënaqësi dhe pasiguri. Dy vjet e gjysmë pas nënshkrimit të marrëveshjes, popullata në veri të Kosovës është ende në një lloj të procesit të tranzicionit për të integruar në sistemin e ri kushtetues dhe ligjor, për ndërtimin e institucioneve të reja dhe pranimin e realitetit të ri politik. Tërë procesi në



Bruksel ka shënuar mungesë të transparencës, që ka prekur më tej zbatimin e tij dhe ka krijuar pasiguri në mesin e qytetarëve në veri. Nga 16 marrëveshjet që janë nënshkruar në Bruksel, vetëm gjashtë zbatohen, kurse zbatimi i plotë i 10 marrëveshjeve janë ende në pritje.

Situata politike "post-Brukselit" në veri ka qenë e shënuar me thellimin e njohurive për pozicionet e reja të serbëve dhe për pozitat e komuniteteve pakicë që veprojnë brenda kornizës kushtetuese të Kosovës. Veprimi i domosdoshëm nga këto pozicione shkaktuan disa shqetësime në mesin e qytetarëve, për ç' arsyeje serbët në veri më shumë se kurrë krahasojnë statusin e tyre me statusin e serbëve në jug të Ibrit dhe hetojnë nevojën për të mësuar nga përvojat e serbëve të cilët tashmë kanë kaluar përmes procesit të integritit në institucionet e Kosovës. Ka pasur një mosbesim të dukshëm ndaj aktorëve politikë dhe ndjenja të pafuqisë që qytetarët të menaxhojnë vetë me fatin e tyre, që ishte pasojë e mungesës së transparencës në negociata që po zhvillohen në Bruksel dhe të rritjes së numrit "mikrointerpretimeve post Brukseli", sepse çdo qytetar ka një vizion të tij për at që do pasoj, gjë që dëshmojnë edhe fjalët e një të anketuara: "mundësi të panumërta mbartin frika të panumërta." Pikërisht, për këtë arsye ishte e nevojshme të shqyrtohen qëndrimet e qytetarëve të veriut për çështjet kryesore me të cilat përballen vendimmarrësit në mënyrë që ata të jenë në gjendje të marrin vendime më të sakëta dhe kështu të avansojnë implementimin e marrëveshjeve të arritura në të ardhmen dhe të kontribuojnë në sigurinë e qytetarëve në veri të Kosovës.



Metodologjia e hulumtimeve - Pjesa kvantitative e hulumtimit -

Mënyra e hulumtimeve: Hulumtimi në terren përmes anketimeve F2F

Koha e hulumtimeve: 4. - 11. qershor 2015.

Vendi i hulumtimeve: Mitrovica veriore , Leposavić, Zubin Potok dhe Zvečani

Madhësia e mostrës : 799 të anketuar

Përshkrimi i mostërave: moshë mesatare 40 vjeç; meshkuj 400 – femëra 394; . Mitrovica veriore 281, Leposavić 204, Zvečan 172, Zubin Potok 137

Tipi mostrës: Mostëra reprezentative e përfaqësuesit të rastësishëm-stratifikimi në bazë të komunës së banimit

Gabimet statistikore: 95% të intervalit të besimit statistik për dukurit me indicent prej 50% sasi+ /- 3,45

Poststratifikacioni: vitetç, niveli i arsimit dhe vendbanimi

- Pjesa kualitative e hulumtimeve -

Mënyra e hulumtimeve: 10 intervista, 4 të fokusuar në grupe dhe 4 tryeza të rrumbullakëta

Vendi i hulumtimeve: Mitrovica veriore, Leposavić, Zubin Potok dhe i Zveçani

Perioda e hulumtimeve: maj –qershor 2015.

Bashkëbiseduesit në intervista: Dejan Đinović, drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicën e Veriut; Rada Trajković, politikane ; Ljubiša Mijačić, bashkëpunor i institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për hartimin e projekteve strategjike, socio-ekonomike dhe infrastrukturore; Rade Utvić, drejtor i Kooperativës Bujqësore në Zubin Potok; zyrtari anonim i EULEX-it; Miloš Subotić, kryetari i Partisë Demokratike në Mitrovicën veriore; Pavle Dimitrijević, drejtor ekzekutiv i Byrosë për Kërkime Sociale;; Veroljub Petronić, magjistër për siguri dhe aktivist në OJQ Qendëra Humanitare, anëtar anonim i Partisë Demokratike të Serbisë, një përfaqësues anonim nga Shërbimi Policor i Kosovës (integruar nga MUP-i); zyrtarët e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Screeener në grupet e faksuara: Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve:sexi,viti, arsimit dhe vendëbanimi



Rezultate më të rëndësishme

Vetëm 4% të anketuarëve vlersojnë situatën aktuale në Kosovë si të mirë.

Çdo i dhjeti anketuar përkrah Marrëveshjen e Brukselit, kurse çdo i dyti nuk ka qëndërim.

56% të anketuar përkrahin pjesëmarrjen e Serbëve në institucionet kosovare.

Vetëm 3,6% të anketuarëve, vlersojnë si të mirë situatën aktuale ekonomike në Kosovë.

Vetëm 14,1% të anketuarëve, situatën aktuale të sigurisë në Kosovë vlersojnë si të mirë.

Nga të gjitha institucionet që mirren me çështjet e sigurisë, të anketuarit më së shumti besim kanë në Mbrojtjen Civile (edhe pse në kohën e zhvillimit të anketimit pat filluar procesi i çformimit të saj- MC).

Sipas mendimit të anketuarëve riziqet më të mëdhaja të sigurisë janë konfliktet ndëretnike, krimi i organizuar dhe papunësia.

83,2% të anketuarëve konsiderojnë se Marrëveshja e Brukselit nuk ka avansuar liritë dhe të drejtat e komunitetit Serb.

43,8% të anketuarëve të rinjë (18-29 vjeç) janë pa punë.

52,2% të anketuar kanë të ardhura nga buxheti i Republikës së Srbisë.

40% e anketuarëve të rinjë (18-29 vjeç) nuk e shohin të ardhmën e tyre në Kosovë.

17,8% të anketuar mendojnë se Asociacioni i Komunave Serbe (AKS) do të ketë autorizime ekzekutive.



Përmbledhja e hulumtimeve: Perceptimi i çështjeve kyçe

Shumica e qytetarëve në veri të Kosovës janë të pakënaqur me situatën aktuale dhe atë e vlerësojnë shumë negativ. Qytetarët po aq negativisht vlerësojnë edhe situatën politike dhe socio-ekonomike si dhe të sigurisë në katër komunat veriore. Vetëm 10% e njerëzve kishin një opinion pozitiv mbi Marrëveshjen e Brukselit, ndërsa më shumë se gjysma e të anketuarve nuk kanë mendim për këtë çështje e cila është shkaktuar nga mungesa e transparencës të Marrëveshjes së Brukselit. Shumica e qytetarëve janë të mendimit se Marrëveshja e Brukselit nuk ka përmirësuar liritë dhe të drejtat e komunitetit serb në Kosovë. Asociacioni i Komunave Serbe (AKS) u konsiderua si një pjesë e rëndësishme e Marrëveshjes së Brukselit, e cila duhet të lehtësojë funksionimin pa pengesë të institucioneve në fushat e arsimit dhe shëndetësisë, por edhe në financimin e vazhdueshëm dhe pa pengesë të komunitetit serb nga ana e Beogradit, që është qartë duke marrë parasysh faktin se më shumë se gjysma e të anketuarve (52.2%) janë drejtpërdrejt të varur nga mbështetja financiare e Beogradit. Pavarësisht nga kjo, shumica e qytetarëve shprehin skepticizëm se BKS do të ketë kompetenca ekzekutive dhe janë të mendimit se me negociata ato nuk do të fitohen.

Me një qëndrim negativ ndaj situatës aktuale, qytetarët po aq negativisht shprehen edhe ndaj institucioneve. Nivelin më të lartë të besimit, thënë kushtimisht, qytetarët kanë ndaj qeverisë në Beograd 14.3% kurse ndaj institucioneve të përkohshme në veri 12.2%. Ndërsa daj komunave të formuara pas zgjedhjeve në vitin 2013 besim ka 10.8% të të anketuarve. Duke pasur parasysh se komunat në veri nuk veprojnë në kapacitet të plotë dhe se qytetarët ende nuk ndiejnë benefitat ekonomike të projekteve të zhvillimit, kjo situatë nuk është e habitshme. Qytetarët në veri ende vazhdojnë të shprehin mosbesim ndaj qëllimeve të Prishtinës zyrtare, siç tregohet edhe me faktin se vetëm 1.3% të anketuarve kanë besim në Qeverinë e Prishtinës.

Pavarësisht nga mungesa e besimit në institucione dhe qëndrimin negativ ndaj Marrëveshjes së Brukselit, shumica e njerëzve mjaft qartë shprehin mendimin se në të ardhmen do të duhet të bashkëpunojnë më shumë me institucionet zyrtare politike, siç dëshmohet edhe nga faktet se 56% e të anketuarve përkrahin pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës, me arsyetim se ajo është mënyra më e mirë për të mbrojtur të drejtat e komunitetit serb në Kosovë. Në të njëjtën kohë 45% e të anketuarve kishin mundësi për të përdorur shërbimet e institucioneve të Kosovës, ndërsa 52% e të anketuarve, kryesisht të moshuar, posedojnë dokumentet e Kosovës. Duket se kur bëhet



fjalë për çështjet që kanë të bëjnë me mirëqenien personale, qytetarët me më shumë spontanitet hyjnë në ndërveprime biznesi, veçanërisht nëse merret parasysh se më shumë se 60% të të anketuar nuk do të kundërshtonin dhe do të pranonin të punojnë në institucionet e Kosovës.

Përveç situatës së paqëndrueshme politike dhe të sigurisë, papunësia shihet si problemi më i madh në veri të Kosovës. Papunësia në veri është jashtëzakonisht e lartë 32.8%. Nëse marrim parasysh grup-moshat, mund të identifikohet se papunësia më e lartë është në mesin e të rinjve të moshës 18 deri 29 vjet, dhe arrin deri në 43.8%. Nëse këtij informacion shtojmë edhe faktin se gati gjysma e të rinjve të anketuar planifikojnë të largohen nga Kosova në pesë vjet e ardhshëm, atëherë është e qartë se të rinjtë nuk e shohin perspektivën në Kosovë.

Në të njëjtën kohë, pavarësisht nga situata ekonomike që është vlerësuar si e pafavorshme, iniciativa private konsiderohet si mënyra më e drejtë për të arritur mirëqenie personale, kështu që më shumë se një e treta e të anketuarve në të ardhmen planifikojnë të fillojnë biznesin e tyre. Ndër arsyet kryesore për të cilat nuk kanë nisur ende bizneset e tyre, qytetarët e përmendin mungesën e financave, tregun e vogël dhe të kufizuar dhe një situatën e keqe të sigurisë që në biznesit të tyre mund të ndikojnë negativisht.

Shumë e rëndësishme është konsideruar çështja e sigurisë në veri të Kosovës, shumica e të anketuarve nuk janë të kënaqur me gjendjen e sigurisë. Si problem më të madhë të sigurisë të anketuarit shohin incidentet e mundshme ndëretnike. Ky shqetësim është shumë e ndryshme nga komuna në komunë, më i madhi është në Mitrovicën e Veriut (54%), e ndjekur nga Zubin Potoku dhe Zveçani (rreth 40%), ndërsa më e ulëta është në Leposavić (32.3%). Përveç konfliktit ndër-etnik, në perceptimin e qytetarëve, krimi i organizuar është i lartë në listën e problemeve të sigurisë.

Kur flitet për institucionet që përkujdesen për siguri, shumica e të anketuarve kanë besim në Mbrojtjen Civile (MC), KFOR-it dhe Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), dhe numrin më i vogël në EULEX-in dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK)¹. Shumica e qytetarëve mendojnë se gjendja e sigurisë nuk ka ndryshuar ndjeshëm që prej integritimit të pjesëtarëve të Mbrojtjes Civile në institucionet e sigurisë së Kosovës. Qytetarët në masë të madhe konsiderojnë se deklaratat e politikanëve nuk po kontribuojnë në

¹ Gjatë hulumtimit në terren, ne gjithashtu kemi përdorur hulumtimet e mëparshme, emri me i njohur i kesaj strukture - Trupave Mbrojtëse të Kosovës




përmirësimin e situatës së sigurisë dhe se ata duhet të jenë më të kujdesshëm kur shprehin pikëpamjet e tyre për çështjet e ndjeshme që mund të krijojnë probleme ndërretnike. Megjithatë, bashkëpunimi e kryetarit të Komunës së Veriut dhe të Jugut të Mitrovicës për qetësimin e situatës së sigurisë, vlersohet pozitivisht dhe një numër i të intervistuarve besojnë se ky bashkëpunim mund të kontribuojë në uljen e tensioneve ndërretnike pas incidenteve në Uren e Ibrit.

Hulumtimet kanë treguar se distanca etnike ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve ende është mjaft e lartë dhe vetëm më pak se 15% të anketuarve të nacionalitetit serb shpesh shkojnë në komunat me popullatë shumicë shqiptare. Megjithatë, 40% e të anketuarve deklarojnë se kanë disa lloj të ndërveprimit me shqiptarët, që është një përmirësim në krahasim me anketat e mëparshme të kryera para Marrëveshjes së Brukselit. Është e qartë se për intensifikimi i kontakteve të drejtpërdrejta personale dhe për vendosjen e besimit mes komuniteteve, duhet të punohet më shumë. Arsyet më të shpeshta për mungesën e ndërveprimeve janë siguria, liria e kufizuar e lëvizjes dhe frika për sigurinë e tyre personale.



Qëndrimet e qytetarëve për situatën politike në Kosovë

Pyetja 1. Si e vlerësoni situatën momentale në Kosovë?



Siç mund të shohim nga grafiku, vetëm 4% të të anketuarve vlerësuan situatën aktuale në Kosovë, si të mirë. Vlersimi mesatar nga shkalla një deri në pesë është 2.09. Me analiza të mëtejshme, shihet se nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në vlerësimin e situatës aktuale në mesin e të anketuarve me arsim të ulët dhe të anketuarëve me arsim të lartë, si dhe në mesin e grupmoshave të ndryshme. I vetmi vend ku shihet dallimi është stratifikimi në bazë të vendbanimit ku kushtëzimisht mund të thuhet se notat më të mira janë në Mitrovicën e Veriut (2.24), ndërsa notat më të këqija në Zubin Potok (1.84). Në Leposavić dhe Zvečanit ku vlerësimet shkojnë rreth 2.

Kur është fjala për informacionet e marra nga grupet e fokusuara, mund të themi se shumica e pjesëmarrësve u pajtuan se situata është shumë e pafavorshme për komunitetin serb. Një nga arsyt kryesore që theksuan pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara është se serbët nga Kosova për asgjë nuk pyeten, se janë të përjashtuar nga procesi i negocimit dhe vendimmarrjes dhe se nuk dihen saktësisht se çfarë zgjidhjet për ta imponohen nëpërmjet marrëveshjeve të Qeverisë në Beograd dhe Prishtinë, me akterët komunitetit ndërkombëtarë.


Një nga të intervistuarit, një ish-figurë politike që dëshiron të mbetet anonim, tha në një intervistë se situata aktuale është shumë e keqe, kurse fajtorët i gjen në të tre anët. Sipas tij "Serbët kurrë nuk humbin mundësi për të humbur mundësin", ndërsa, nga ana tjetër, thekson se bashkësia ndërkombëtare "është fajtores për rrëzimin e demokracisë dhe sistemit politik në Kosovë, sepse asgjë nuk ka bërë për të



demokratizuar shoqërinë kosovare". Nga ky dështim i komunitetit ndërkombëtar rrjedh paradoksin se "fati i popullit serb në Kosovë është shumë më e komplikuar tani se sa ishte në vitin 1999, menjëherë pas agresionit të NATO-s." Për rolin e qeverisë së Kosovës thotë se e vetmja arsye që serbët pranojnë pjesëmarrjen në institucionet është presioni ndërkombëtar.

Miloš Subotić, presidenti aktual i Partisë Demokratike në Mitrovicën Veriore, pozicionin e tanishëm të serbëve në Kosovë vlerëson si shumë keq dhe e quan atë "një lloj i butë (*soft*) i aparteidit". Ai pohon se "më e keqja është se ata të gjithë e pranojnë këtë gjendje si normale. Është bërë e zakonshme të digjen shtëpitë e të kthyerëve në Klinë, dhe kjo nuk bëhet është lajm në media. "

Pyetja 2. Si vlerësoni situatën politike në Kosovë?



Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, vetëm 2.4%, tha se situata politike në Kosovë është e mirë ose shumë e mirë, ndërsa 81.2% e të anketuarve vlerësuan situatën politike si keq ose shumë të keq. Në shkallë nga 1-5, situata politike është vlerësuar me notë mesatare prej 1.7. Sipas të gjitha kriterëve të poststratifikimit (mosha, vendbanimi dhe niveli arsimor), kemi afërsisht të njëjtën vlerë.


Lidhur me njohurit e grupeve të fokusuar, shumica e pjesëmarrësve tregoi mosbesim të caktuar ndaj përfaqësuesve politikë, sepse mendojnë se numri i njerëzve që kanë dalë në votime nuk jep legjitimitet të mjaftueshëm për përfaqësuesit e autoriteteve lokale dhe qendrore për të kryer detyrat në emër të qytetarëve. Në anën tjetër, pjesëmarrësit mendojnë se, edhe kur ata janë në institucione, përfaqësuesit serbë duhet



të punojnë shumë më mirë dhe më efikasitet, në mënyrë që të ndihmojnë dhe të mbrojnë të drejtat e komunitetit serb në Kosovë.

Rada Trajković kritikon deputetët serbë se nuk parashtrojnë më aktivisht qëndrimet e tyre me qëllim që ndal ngadalë të përfitojnë opinionin publik. "Unë këtu referohem kryesisht Ambasadave që monitorojnë çdo sesion të Kuvendit, ku mund vërtetë të dërgohen shumë mesazhe - edhe pse ata nuk do të dëgohen mirë në Kuvend, e as në radhët e opinionit publik shqiptar, megjithatë do të dërgohen mesazhe të qarta të tjerëve të cilët megjithatë ende kanë fuqinë për të vendosur për Kosovën. "

Pyetja 3. A keni shfrytëzuar shërbimet e institucioneve të Kosovës?




Përgjigjet në këto pyetje mund të krahasojmë në bazë të vendbanimit ku shihet se në Mitrovicën veriore qytetarët janë më pak të kënaqur me shërbimet e institucioneve të Kosovës, ndërsa të anketuarit më të kënaqur janë ata nga komuna e Zveçani. Këto përgjigje duhet të merren me rezervë, sepse pushtetet lokale në veri ende nuk janë konstituuar plotësisht dhe qytetarët nuk e dinë dallimin në mes të komunave që janë konstituuar pas zgjedhjeve lokale në vitin 2013. dhe formimit të organeve të përkohshme.

	Po kam qene i kenaqur me sherbime	Po,por nuk kam qene i kenaqur me sherbime	Nuk kam shfrytezuar
Severna Mitrovica	20%	30%	50%
Zubin Potok	23,9%	23,9%	50,2%
Leposavić	20,2%	16,6%	63,2%
Zvečan	24,4%	20,3%	55,3%




Pyetja 4. A posedoni dokumentat personale të lëshuara nga ana e institucioneve Kosovare?



Numri më i madh (76%) të atyre që kanë dokumente personale të lëshuara nga institucionet e Kosovës i përkasin brezit të vjetër e të anketuarve. Sa i përket nivelit të arsimimit, vendbanimit, në përgjegjet e tyre nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm.

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara veçanërisht kanë theksuar se politikanët serbë në institucionet lokale dhe qendrore duhet të kushtojnë më shumë vëmendje çështjeve themelore jetësore siç janë sigurimi i dokumenteve, certifikatave, vërtetimeve aplikimeve e të ngjashme. Gjithashtu, pjesëmarrësit theksojnë se për ta është me rëndësi të madhe të bëhet një marrëveshje e gjerë se a duhet dokumentet të nxirren në institucionet e Kosovës apo këto institucione duhet të bojkotohen. Në veçanti, ata ishin të shqetësuar për mosnjohjen e diplomave të Universitetit të Prishtinës, me seli të përkohëshme në Mitrovicë dhe pengesat të ngjashme burokratike në baza nacionale.

Pyetja 5. Kçfar është qëndrimi i Juaj ndaj Marrëveshjes së Brukselit?





Siç mund të shohim, informacioni më i rëndësishëm lidhur me këtë pyetje që siguroam në terrenë nuk është se vetëm 10% e të anketuarve përkrahin këtë marrëveshje, gjë që në nivelin intuitive mund të pritej, por numri i të anketuarve që abstenuan është shumë i madh.


Nëse marrim parasysh mbështetjen për Marrëveshjen e Brukselit përmes ndryshimit të mosheve mund të shohim se Marrëveshja e Brukselit më pak mbështetet nga të rinjtë të moshës 18 deri në 29 vjeç (6.6%), pastaj nga të anketuarit prej 30 deri 45 vjet (9.3%), të anketuarit nga 46 deri në 65 (11, 6%), dhe kushtimisht thënë, mbështetjen më të madhe për Marrëveshjes së Brukselit kanë të anketuarit të cilët janë më të vjetër se 66 vjet (17.3%).

Përgjigjet e grupeve të fokusuara ,kryesisht, përqëndrohen në atë se marrëveshjet mund të kuptohet në dy mënyra, kështu që askush nuk mund të përcaktojë saktësisht se çfarë konkretisht shkruan dhe thuhet në këto marrëveshje. Pjesëmarrësit theksojnë se si shumë shpesh mund të shihet se shtypi shqiptar dhe serb marrëveshjet e interpretojnë në mënyrën e vet. Përveç kësaj, pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara theksojnë se i gjithë procesi nuk është transparent dhe që për të gjithë qytetarët të interesuar nuk janë në dispozicion informacionet lidhur me procesin e negociatave dhe vendimet e marra. Gjithashtu, kur është fjala për rezultatin përfundimtar të negociatave dhe kuptimin e saj simbolik, në grupet e fokusuara u dëgjuan fjali të tilla si "ne të gjithë e dimë se ky proces është zyrtarizimi i Kosovës si shtet."

Kur bëhet fjalë për anët pozitive të Marrëveshjes së Brukselit, pjesëmarrësit theksojnë: realizimi i kontakteve dhe të bisedave të të dy palëve (Beogradit dhe Prishtinës), ulja e tensioneve politike që ka reduktuar numrin e palëve të interesuara dhe, më në fund, zgjimi i njerëzve dhe zvogëlimi e pasigurisë, siç ilustron nga marrëveshja ", tani diçka është vendosur, më herët ka pasur mundësi të panumërta - frikë pafund "

Megjithatë, frika vazhdonë të ekzistoj. Pjesëmarrësit konsiderojnë se integrimi politik në institucionet e Kosovës është bërë relativisht qetë, por presin reagim më të ashpër nga komuniteti serb kur bëhet fjalë për rritjen e shkallës së integritimit ekonomik dhe rënien e mundshme të cilësisë për kujdesin shëndetësor dhe të arsimit.

Pyetja 6. Çfar është qëndrimi i Juaj për pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës?



Të anketuarit nga të gjitha grupmoshat japin përgjigje për afërsisht të njëjtën, nga mbështetja prej 52% që japin të rinjtë dhe mbështetja 61,7% nga radhët e të anketuarve të grup-moshës prej 30 deri në 45 vjeç, ata mendojnë se pjesëmarrja politike e serbëve në institucionet e Kosovës është i mirë. Këto të dhëna janë shumë interesante sepse tregojnë se përkundër mungesës së besimit të popullsisë lokale në procesin e negociatave në Bruksel, shumica e qytetarëve intuitivisht pranojnë realitetin politik dhe nevojën e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të komunitetit serb në institucionet e Kosovës. Një numër i qytetarëve të grupeve të fokusuara theksuan faktin se përfaqësuesit politikë kanë marrë pjesë në zgjedhjet lokale dhe parlamentare dhe kështu kanë dhënë legjitimitet institucioneve dhe shtojnë se në to duhet marrë pjesë sepse kështu mund të luftohet për një pozitë më të mirë të komunitetit serb në të Kosovës.

Kur shikohet shpërndarja e përgjigjeve në këto pyetje në varësi prej vendbanimit sigurohen informacionet si vijojnë:

Pranon pjesëmarrjen

Mitrovica e veriut	61,5%
Zvečan	58,4%
Leposavić	54,1%
Zubin Potok	48,1%

Rezultatet e punës së institucioneve të Kosovës, sipas mendimit të pjesëmarrësve të grupeve të fokusuara, ende nuk janë të dukshme. Institucionet nuk funksionojnë, por edhe kur ata funksionojnë kanë qëndrim diskriminues ndaj qytetarëve të nacionalitetit serb. Sa për serbët që punojnë në institucionet e Kosovës, sidomos në qendër, shumica e të anketuarve mendojnë se ata nuk kanë mundësi për të bërë diçka më shumë për



komunitetin serb, sepse janë një pakicë në krahasim me forcat politike shqiptare, apo edhe në anën tjetër, ata janë shumë të varur nga autoritetet në Beograd. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara angazhimin e tyre e shikojnë me rezervë dhe theksojnë dy pengesa të mëdha në arritjen e rezultateve: mungesa e fuqisë për të iniciuar ndryshime dhe mungesa e kualifikimeve dhe burimeve njerëzore. Pavle Dimitrijević nga BIRODI beson se Beogradi ka një rol dominues në jetën politike të Kosovës dhe lëvizjet politike të politikanëve serbë, por thekson se kjo nuk mund të jetë aq e keqe sepse përndryshe situata do të ishte shumë më keq për serbët. Qëndrimi Dimitrijeviqit është që serbët duhet të marrin pjesë në ato institucione ku mund të përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve në veri të Kosovës. Ai gjithashtu shton se me pjesëmarrjen politike të serbëve në institucionet e Kosovës, hapsira manovruese në këto institucione ndjeshëm është i ngushtuar, sepse tani edhe shteti i Serbisë ka dërguar porosi të qartë se pranon institucionet në jug dhe në veri të Kosovës. "Shteti i Serbisë ka dërguar një mesazh të qartë se sistemi i Kosovës është i pranueshëm edhe në zonat ku serbët janë shumicë dhe se do të jetë operacional në të ardhmen. Pyetja e vetme është - se si do të funksionojë ky sistem? "

Një tjetër aktivistë i shoqërisë civile, Veroljub Petronić, ka një pikëpamje disi të ndryshme për situatën. Sipas tij, e vërteta është se me përmbushjen e mëtejshme të pikave nga Marrëveshja e Brukselit, Serbia po humb kontrollin mbi situatën në Kosovë, por, edhe Prishtina do të duhet të mësohet me faktin se serbët gjithnjë e më shumë do të jenë në institucionet e saj. Përveç kësaj, ai vë në dukje se nuk duhet të injorohet fakti se serbët në të ardhmen e afërt mund të bëhen faktor i rëndësishëm në luftën politike mes partive politike shqiptare.

Numri më i madh i pjesëmarrësve në grupet e fokusuara, tha se në ciklin e fundit zgjedhor, shumica ishin kundër pjesëmarrjes në zgjedhje dhe se këto distanca për ta ishin të gabuara meqë tani në pushtet janë njerëzit që nga ana e tyre nuk janë zgjedhur. Mendimi i shumicës së pjesëmarrësve në grupet e fokusuara ishte se serbët duhet të marrin pjesë në institucionet e Kosovës dhe se kjo është e vetmja mundësi që, përfaqësuesit e vërtetë të përfaqësojnë interesat e serbëve. Te të anketuarit që ishin kundër pjesëmarrjes në institucionet e Kosovës, argumenti kryesor për këtë qëndrim ishte se me këtë njihet Republika e Kosovës.


Kur u pyetën në lidhje me pjesëmarrjen në zgjedhjet e ardhshme lokale, shumica e të anketuarve parashikojnë se pjesëmarrja do të jetë në rritje në krahasim me nëntorin e vitit 2013. Kështu, përfaqësuesi i qeverisë së mëparshme dhe anëtar i PDS, thotë se zgjedhjet e ardhshme do të jenë po aq të parregullta si ata në zgjedhjet e vitit 2013, por



me një pjesëmarrje më të lartë nëse në zgjedhje përfshihen më shumë parti. Sipas tij, problem serioz është mungesa e aftësisë për politikë në mesin e votuesve të cilët janë tashmë të lodhur me proceset zgjedhore dhe me rezultate të njëjta, por me aktorë të ndryshëm. Si çelës për rivitalizimin e jetës politike ai e sheh përfshirjen e të rinjve në procesin politik dhe përkujton rolin e duhur të politikanëve – krijimin e parakushteve politike dhe ekonomike për vetëpunësim dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore.

Rada Trajković, ka thënë se me kohë njerëzit janë mësuar në veprime politike të serbëve në institucionet e Kosovës dhe sot një numër shumë më i madh i njerëzve mendojnë se diçka mund të ndodhë dhe të ketë zgjidhje brenda atyre institucioneve që janë duke u ndërtuar. Ajo beson se "shumë më me përgjegjësi është të jenë të përfshirë, të angazhuar dhe në pozita ku mirren vendimet, për shkak se për serbët kurrë nuk do të jetë lehtë."

Pyetja 7. Në shkallën prej një deri pesë, vlerësoni se sa jeni të kënaqur me punën e institucioneve të theksuara?



Përgjigjet në këtë pyetje kanë treguar se qytetarët në grupet e fokusuar shpesh nuk e dinë dallimin në mes të komunave të sapoformuara dhe institucioneve të përkohshme. Për më tepër, rezultatet flasin se në veri institucionet e sapoformuara nuk janë të jetësuar mjaftueshëm dhe nuk janë bërë të njohur, andaj më shumë besim ipet institucioneve që janë në procesin e çformimit dhe atyre që transformohen dhe integrohen në sistemin kosovar, që tregojnë "dëshirën e zjarrtë për një të kaluar më të mirë." Vendimi politik që të shpërbëhen institucionet, gradualisht, në kontekstin e ruajtjes së stabilitetit të sigurisë dhe politik ishte i saktë, sepse ajo mbajti një paqe të brishtë.



Kur është fjala për institucionet e Kosovës dhe për at nëse atyre mund të besohet, pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara në përgjigjen e tyre ishin rënë dakord që ata nuk besojnë as institucioneve lokale e as atyre qendrore, duke theksuar se bashkësia ndërkombëtare mbanë stabilitrin politik, por edhe çdo lloj tjetër i stabilitetit në Kosovë dhe se presioni i shqiptarëve të Kosovës tek serbët do jetë shumë më i madh kur "të huajt" largohen nga Kosova. Prandaj, pavarësisht nga mungesa e besimit, është me rëndësi të jenë të përfshir në ngjarjet.

Pyetja 8. Në shkallën prej një deri më pçesë, ku njëshi nënkupton nuk pajtohem plotësisht, krse pesëshi pajtohem plotësisht, si do të vlerësoni këto qëndrime mbi Asociacionin e komunave serbe?

Pajtohet me pohimin

AKS do të kontribuoi në përmirësimin e pozitës së serbëve në Kosovë	26,9%
AKS do të kontribuoi integritit të serbëve në sistemin juridiko-politik të Kosovës	26,3%
AKS do të mundësoi zhvillimin ekonomik dhe punsimin	18,9%
AKS do të ketë autorizime ekzekutive	17,8%

Hulumtimet janë kryer dy muaj para nënshkrimit të marrëveshjes për formimin e komunave serbe në Bruksel më 25 gusht. Gjatë studimit kërkimor, qytetarët ishin disi skeptikë në lidhje me rolin e ardhshëm të AKS, duke pasur parasysh se ata në atë kohë nuk kanë pasur informata të mjaftueshme mbi këtë marrëveshje. Kjo është një nga arsyet se shumica e qytetarëve kanë shprehur mosbesimin ndaj Marrëveshjes së Brukselit në përgjithësi dhe besonin se ajo nuk do të çojë në prosperitet. Megjithatë, qytetarët kanë më shumë besim kanë për pjesën që ka të bëjë me Marrëveshjen lidhë me AKS. Në pyetjen "Cili është qëndrimi juaj ndaj AKS?" dhe "A do të forcojë pozitën e komunitetit serb në Kosovë?", Pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara theksuan se krijimi i AKS është kryesisht i rëndësishëm për funksionimin e shëndetësisë dhe arsimit, por edhe u pajtuan se nuk kanë informacione konkrete mbi atë se si do funksionojë Asociacioni "zajednica".

Disa pjesëmarrës shprehën dyshime për tërë projektin, duke argumentuar se "AKS tingëllon bukur, por na gënjen", sepse ajo do të hyjë në fuqi vetëm nëse do të miratohet nga Prishtina ", dhe ne e dimë se Prishtina nuk do të miratojë diçka që është kundër



interesave të saj." Intuitivisht, një numër i madh i pjesëmarrësve të sondazhit shprehën dyshime se do të ketë ndryshime në kornizën ligjor në mënyrë që të AKS të inkorporohet në sistemin e Kosovës. Gjithashtu, një numër i madh i qytetarëve shprehën dyshimin se AKS do të ketë kompetenca ekzekutive. Marrëveshja e re në Bruksel nuk është qartë e mjaftueshme në pjesën lidhur me kompetencat e AKS, dhe në këtë moment, para miratimit të statutit, ata nuk po mundën me thenë me siguri se çfarë do të jenë ato kompetenca. Ajo se çfarë kuptojnë pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara në përgjithësi është se qeveria në Beograd ishte nën një presion të madh dhe se edhe përkundër pakënaqësisë dhe mosbesimit të qytetarëve në veri ishte i detyruar të pranoi Marrëveshjen e Brukselit.


Të anketuarit konsiderojnë se "krijimi i AKS është plan i mirë për qëndrimin e serbëve në Kosovë, por kjo është praktikisht e pazbatueshme, dhe për këtë arsyeja ajo zhvarritet." Kur shqyrtohen qëndrimet e qytetarëve të grupeve të fokusura, shumica e pjesëmarrësve shohin rolin e AKS në procesin e zhvillimit ekonomik dhe financimit të vazhdueshëm të komunitetit serb nga Beogradi, si dhe qëndrueshmërin e sistemeve të shëndetësisë dhe arsimit. Funkcionimi i shëndetësisë dhe arsimit është parë si një vijë e kuqe që nuk duhet të kalohet. Qytetarët mendojnë se komunat që sipas ligjeve të Kosovës kanë ingerenca mbi shëndetësin dhe arsimin primar dhe sekondar nuk mund të menaxhohen me sisteme të tilla të ndërlikuara pa një lloj "ombrelle" siç është Asociacioni i Komunave Serbe, i cili duhet të koordinojë funksionimin e këtyre sistemeve.

Rada Trajković beson se Serbia ka bërë një gabim të madh, sepse zbatimi i marrëveshjes tërhoqi institucionet serbe nga territoria e Kosovës dhe lejoi që institucionet e Kosovës të ringjallen, në vend që më parë të punohet në krijimin dhe forcimin e kapaciteteve të AKS.



Qëndrimet e qytetarëve mbi situatën ekonomike në Kosovë

Pyetja 9. Si do të vlerësoni situatën aktuale ekonomike në Kosovë?



Rezultati mesatar i situatës ekonomike në Kosovë është 1.84. Situatën ekonomike më së keqi vlersuan të anketuarit në Zubin Potok (1.57), ndërsa të anketuarit situatën më së miri vlersuan në Mitrovicën e Veriut (1.91). Analizat e mëtejshme tregojnë se pavarësisht nga statusi i punësimit dhe burimit të të ardhurave, të anketuarve dhënë përgjigje të ngjashme.

Si shkak kryesor i stagnimit të ekonomisë, gjendjes së vështirë ekonomike dhe pakënaqësisë, pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara theksuan dy karakteristika: papunësinë jashtëzakonisht të lartë dhe mungesën e ndërmarrjeve prodhuese ose subjekteve ekonomike që gjenerojnë fitime.


Për mënyrën se si Marrëveshja e Brukselit pasqyron ekonominë e Kosovës veriore ne biseduam me bashkëpunëtorët e institucionve vendore dhe ndërkombëtare për përpilimin e projekteve strategjike, socio-ekonomike dhe të infrastrukturës, Ljubiša Mijačić theksoi se integrimi ekonomik i veriut u bë në atë masë sa ishte e lejuar nga Beogradi dhe sa ishte bërë presion mbi Prishtinën. Shkallën e integrimit Mijačić e përshkroi si një "ngushtim", që tani përfshin vetëm lëshimin e mallrave dhe shërbimeve në vendkalimet administrative. Megjithatë, ai ndryshoi mënyrën bizneseve të afaristëve lokalë, të cilët tani nuk mund të bëjnë biznese me regjistrimet e ARE, por janë të detyruar të regjistrohen si subjekte tregtare në Kosovë. Me përfundimin e integrimit të policisë, dhe me integrimet që do të pasojnë, e gjithë procesi i integrimit socio-ekonomik do të bëhet një "proces i rrumbullkuar", kështu që ky ngushtim do të zgjerohet "dhe



asnjë pjesëmarrës në sistemin ekonomik nuk do të jetë në gjendje të veprojë mbi parimin që funksiononte më parë për subjektet ekonomike të regjistruara në ARE. "

Kur është fjala për moszhvillimin e sektorit të prodhimit privat, Mijačić citon dy arsye. E para është se serbët në veri për 15 vjet që jetojnë në një mjedis të pasigurt politike dhe të sigurisë nuk ishin të përgatitur për të menduar dhe të investuar në ndërmarrje afatgjatë. Një tjetër arsye është se në një farë mënyre serbët ishin "cocooned" (mbështetur) nga shpenzimet publike dhe pagat nga Serbia.

Pyetja 10. Në shkallën prej një deri në pesë, sa jeni të kënaqur me situatën e juaj materijale?




Sipas të dhënave të Qendrës për Punë Sociale në veri të Mitrovicës të marra nga drejtori i këtij institucioni, Dejan Đinović, rreth 1300 persona nga gjashtë komuna, për të cilat Qendra është autorizuar (Mitrovicë, Zveçan, Pejë, Istog, Klinë dhe Rahoveci) e shfrytëzojnë shërbimet e Qendrës në formën e ndihmës financiare, ndërsa 166 familje kanë të drejtë për kujdes dhe ndihmë. Dejan Đinović thekson se pozita e kategorive më të rrezikuara sociale nuk është ndryshuar me nënshkrimin e Marrëveshjes së Brukselit dhe me procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës, nuk ka asnjë tregues që flet për ndryshimet në mirëqenien sociale.

Kur është fjala për gjendjen financiare, të anketuarit në pjesën veriore të Mitrovicës më së miri vlerësuan gjendjen e tyre (2.66), kurse më së keqi ata nga Zubin Potoku (1.99). Sa i përket elementeve të tjera të poststratifikimit, të dhënat e siguruar nga të anketuarit tregojnë se më së keqi janë pozicionuar ata në arsimin fillor (2.1), ndërsa



pozitën e tyre materiale, më së miri kanë vlersuar të anketuarit me diploma universitare (2.77).

Pyetja 11. Cili është statusi juaj i punësimit?



Më së pakti të papunësuar ka në Mitrovicën e veriut, kurse shkalla më e lartë e papunësisë është në komunën e Leposaviqit.


Mitrovica e Veriut	29,4%
Zubin Potok	34,1%
Zveçan	34,9%
Leposaviq	35,1%

Nëse marrim parasysh grupmoshat, shkalla më e lartë të papunësisë është në mesin e të rinjve të moshës 18 deri 29 vjet dhe arrin në 43.8%. Ky informacion është shqetësuese, sepse perspektiva për të gjetur një punë është një nga arsyet kryesore pse 40% e të rinjve të anketuar duan të largohen nga Kosova.

Në një intervistë me zyrtarët nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit kemi kuptuar se, aktualisht, në tregun e punës më të kërkuar janë zanatlit, dhe se sektori i IT është më pak të zhvilluara




Pyetja 12. A janë të ardhurat tuaja nga buxheti i Republikës së Serbisë?



Kur shikojmë strukturën e të anketuarve të cilët marrin para nga buxheti i Republikës së Serbisë, shumica prej tyre (93.2%) i takon brezit më të vjetër se 66 vjet, pastaj janë ata të anketuarit prej 46 deri në 65 vjet (65.4%) dhe, nga 30 deri në 45 vjet (49,6%) dhe në fund, të anketuarit që i përkasin popullatës më të re të moshës 18 deri 29 vjet (35.8%). Këto të dhëna më tej shpjegojnë shqetësimet e qytetarëve në veri në lidhje me Marrëveshjen e Brukselit dhe themelimin e AKS. Duke pasur parasysh se stabiliteti socio-ekonomik dhe siguria e shumicës së qytetarëve varet prej financimit nga Beogradi, pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara janë të mendimit se financimi nga Beogradi duhet të mundësoi sigurimin e vendeve ekzistuese të punës, projekteve të infrastrukturës financiare dhe përfitimet sociale. Të anketuarit besojnë se financimi nga Beogradi duhet të mundësoi ruajtjen e stabilitetit në veri të Kosovës dhe të përmirësoi cilësinë e jetës ekzistuese. Nëse si rezultat të zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit do jenë shkurtimet financiare nga Beogradi dhe humbja e vendeve të punës, ajo mund të shkaktojë një krizë sociale, duke përfshirë migracionin afatgjatë të popullsisë nga veriu, vlersojnë pjesëmarrësit grupeve të fokusuara. Nga ana tjetër, besojnë se përfitimet janë në shumicën e rasteve të pamjaftueshme dhe se është numëri i vogël i atyre që jetojnë komodë.



Pyetja 13. A keni ndërmend të filloni biznesin e juaj në dy vitet e ardhshme?




Numri më i madh i të anketuarve të cilët planifikojnë të fillojnë një biznes, shikuar përmes shkallës së arsimit, përbëhet prej të anketuarve të cilët kanë përfunduar fakultetin (37.5%), ndërsa numërin më të vogël përbëjnë të anketuarit me arsim fillor (10.9%). Pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara besojnë se kultura sipërmarrëse dhe iniciativat private ekzistojnë në veri dhe ato atje zhvillohen me shpejtësi. Një numër i madh i njerëzve nuk e shohin perspektivën në sektorin publik, por në hapjen e ndërmarrjeve private, të cilat mund të jenë të atilla që të kontribuojnë të ardhurave të qëndrueshëm për familjet e tyre.

Për përvojat nga bizneset private biseduam me sipërmarrësin Rade Utvić. Ai thotë se "sa i përket ekonomisë, ne nuk kemi gjëra të mira për të thënë për shkak se sistemi nuk është ngritur si duhet. Sinqerisht, ne bëjmë atë që ne mund të arrijmë, por kushtet janë shumë të vështira dhe kjo është ajo që partnerët tanë vërrejnë sëpari, kur ata vijnë këtu. "Megjithatë, kur e pyetën në lidhje me çfarë shkalle ai si një biznesmen nga veriu ka qasje në treg në jug të lumit Ibër, Utvić tha se nuk ka probleme me botën e biznesit, ekziston bashkëpunimi për përfitim reciproke, por thekson se "gjithmonë mund të haset ndonjë ekstrem. "



Pyetja 14. Çka do deklaroni se është pengesë e madhe për të filluar një biznes në Kosovë?




Edhe pse pjesëmarrësit e fokus grupeve të theksuan nismën private sipërmarrëse shohin si një nga zgjidhjet e mundshme për të dale nga gjendja e keqe ekonomike në terren, pjesëmarrësit janë të vetëdijshëm se ka shumë pengesa tjera për zgjerimin e tyre. Këto pengesa përfshijnë mungesën e interesit dhe vetë-iniciativën, obligimin e përcaktimit ndërmjet dy kornizave ligjore (serbe apo Kosovare), monopolizimin, prirjen e ulët për rrezik, mungesën e kapitalit fillestar dhe të burimeve njerëzore. Përveç fondeve që mund të merren nga grantet prej agjencive donatore ndërkombëtare, qeverive dhe qeveritë lokale, mundësitë e huamarrjes korporatave nga bankat lokale për të filluar një biznes janë të kufizuara dhe janë me norma të larta interesi për shkak të zonës së rrezikshme të biznesit. Në këto kushte, numri i vogël i qytetarëve kanë mundësi që, pavarësisht ideve të mira, të fillojnë bizneset e tyre. Në anën tjetër, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve më shumë preferojnë vendet e punës në institucionet shtetërore për shkak të sigurisë më të lartë të punës.

Gjithashtu, pjesëmarrësit e grupeve të fokusuar përmendin disa probleme konkrete të tilla si mungesa e standardeve fitosanitare, si dhe futjen e tarifave doganore si një tjetër pengesë serioze për zhvillimin e sipërmarrjes. Një biznesmen i cili ishte pjesëmarrës në një grup të fokusuar si problem serioz theksoi taksat e vëna në mënyrë retroaktive kompanive serbe të regjistruara në UNMIK që nga viti 2001 që për shkak të shkallës së lartë të interesit përbënë një barrë të tepërt financiare për çdo ndërmarrje pa marrë parasysh se sa fitim realizon.



Pyetja 15. Në cilët sektorë shihni potencial për zhvillimin ekonomik të komunave serbe në veri të Kosovës?




Ljubisha Mijačić thekson se ajo që ekonomikisht e mban komunitetin serb në Kosovë është mbështetja me para nga Serbia, kryesisht pagat në sektorin publik dhe eksternalitetet e saj në industrinë e shërbimeve: "Kur derdhen paratë atëherë edhe pjesëmarrësit tjerë siç janë restorante, dyqane, kafene dhe industritë e tjera kanë përfitime dhe kështu fuqizohet sektori privat forcohet. Megjithatë, sistemi nuk është vital sepse komunitetet serbe në tërë tregun e Kosovës ende nuk funksionon dhe nuk është konkurent." Mijačić u pyet në lidhje me Fondin Zhvillimor të Veriut, ku ai tha se ate që e din për Fondin për Zhvillim, është se dispozitat ligjore të Kosovës janë të depozituar deri në vitin 2017. dhe deri tani ka mbledhur rreth 6 milionë euro, por që ende nuk dihet se për çfarë do të përdoren këto mjete. "Disa pohojnë se mund të shkojnë vetëm në projekte infrastrukturore, të tjerët thonë edhe në projekte socio-ekonomike. Unë para së gjithash do të doja për të parë që të themelohen fonde lokale, respektivisht fonde për kredi lokale për zhvillimin e sipërmarrjeve, sepse në infrastruktura ka shumë donatorë të tjerë, që krijojnë kushte për të forcuar kapacitetet të infrastrukturës, përmes USAID-it, të BE-së, Munifrit ose me ndonjë kornizë tjetër, por ajo që mungon është një nxitje e vërtetë për kreditim dhe financim të prodhimeve të ndërmarrjeve."

Drejtor i Kooperativës Bujqësore në Zubin Potok, Rade Utvić vë në dukje dy lloje të potencialit ekonomik: resurset strategjike (energji elektrike, qymyr, minjerat), të cilat kërkojnë investime të mëdha dhe kapital ku individit nuk ka rëndësi të veçantë, dhe ato



potenciale që mund të zhvillohen në tërë territorin e Kosovës për të komunitetet etnik që jetojnë atje, e ato janë resurset bujqësore. "Ne nuk kemi çfarë të kërkojmë në industrializim, qoftë në Serbi apo në Kosovë. Industrializimi ishte dikur, kur ka pasur një ekonomi e planifikuar, atëherë kur firmat ishin të detyruar të lidhen me njëri-tjetrin, sot tregu është i hapur, në qoftë se keni nevojë për një vidë të zakonshëm dikush atë tashmë ka importuar nga Kina. " Utvić shtoi se as blegëtorija më degë me perspektivë në sektorin e ekonomisë, të paktën jo në rrethanat që mbizotërojnë ku ushqimi për bagëti për shkak të importit është deri në 20% më shtrenjtë se në Serbi. Derisa kjo të ndryshojë, vetëm blegësia ekstensive të kafshëve, që do të thotë se bagëti një pjesë të mirë të ushqimit që merr nga kullosat ka një perspektivë, ndërsa blegësia intensive në ferma vështirë mund të jetë fitimprurës.

Pyetja 16. Nëse ju ose të afërmit tuaj merrni një ofertë për të punuar në institucionet e Kosovës, çfarë do të jetë qëndrimi juaj?




Të anketuarit e të gjitha grupmoshave, nivelit arsimor, vendbanimit dhanë përgjigje në një gamë të ngjashme.



Pikëpamjet e qytetarëve mbi gjendjen e sigurisë në Kosovë

Pyetja 17. Si do ta vlerësoni situatën aktuale të sigurisë në Kosovë?




Situata e sigurisë në Kosovë është vlerësuar me notë mesatare 1.8. Më së miri është vlerësuar Leposaviqi (1.94), dhe më e keqe Zubin Potoku (1.58). Në grupet e fokusuar, pjesëmarrësit poashtu theksuan se gjendja e sigurisë është shumë e keqe. Shumica thanë se ndjehen të sigurt vetëm në oborrin e tyre dhe në komshilluk, dhe se nuk ndjehen të sigurt në pjesët tjera të Kosovës. Pjesëmarrësit theksuan se liria e lëvizjes është e rrezikuar në çdo kuptim të fjalës. Pjesëmarrësit përmendën se as me integrimin e policisë serbe në SHPK-a asgjë pozitive nuk ka ndodhur, përveq numrit më të madhë të policëve nëpër rrugë. Tensionet, frika dhe mosbesimi janë ende karakteristikat kryesore të situatës së sigurisë.

Duke vlerësuar sigurinë në veri të Kosovës, përfaqësuesi i EULEX-i konsideron se situata tani është shumë më e qetë se më parë, dhe se ka disa kërcënime të sigurisë të cilat janë më të shprehura në jug sesa në veri, dhe atje, mbi të gjitha mendo për ekzistencën e luftëtarëve në Siri dhe Irak.




Pyetja 18. A është kërcënuar siguria juaj ose siguria e familjes tuaj në gjashtë muajt e fundit?



Numri më i madh i të anketuarve që thanë se siguria e tyre do të rrezikohet vjen nga komuna e Zubin Potokut (19.3%) dhe Mitrovica e veriut (16.8%). Në mënyrë të konsiderueshme më pak janë të rrezikuar personalisht të anketuarit nga Komuna e Leposaviqit (7.2%) dhe komuna e Zveçanit (6.3%).

Pavarësisht nga fakti se ata nuk ishin të kërcënuar direkt fizikisht, shumica e pjesëmarrësve të grupeve të fokusuar përgjithësisht perceptohet situatën në veri si të pasigurt. Një numër i pjesëmarrësve theksuan numrin e madh të aktakuzave për qytetarët e veriut, veçanërisht për banorët e Zubin Potokut, që edhe më shumë te ate shton frikën dhe mosbesimin në institucionet. Për këto qëndrime është më shumë kanë ndikuar rritja konstante e tensionet nga ana e elitës politike përmes mediave elektronike dhe të shtypura, sepse një numër i qytetarëve besojnë se politikanët shpesh japin deklarata të pamatura të cilat nuk kontribuojnë në stabilitet.


Pyetja 19. Vlerësoni sa jeni të kënaqur me punën e shërbimeve të theksuara?





Të gjithë të anketuarit, pavarësisht nga mosha, arsimi dhe vendbanimi janë më të kënaqur me punën e Mbrojtjes Civile, dhe më së pakti me Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Anketa hulumtuese është kryer para integritit të plotë të Mbrojtjes Civile, pra në periudhën kur ajo ende funksiononte me kapacitet të plotë, dhe këto rezultate nuk janë të papritura. Në përgjithësi, qytetarët kanë më shumë besim në KFOR, i cili, sipas mendimit të tyre, vepron nën mandatin e Rezolutës 1244 të OKB-së, që është neutral ndaj statusit. Gjithashtu vërrehet se pas integritit të pjesëtarëve të MUP-it është në rritje të lehtë besimi ndaj SHPK-së. Në një intervistë, Rada Trajković, theksoi se "aleati ynë kryesor i strukturave të sigurisë duhet të jenë forcat ndërkombëtare të sigurisë -në këtë rast të NATO-s" Megjithatë, në perspektivën afatgjatë ", ne duhet të kemi parasysh se forcat ndërkombëtare në një kohë do të tërhiqen dhe për këtë arsye çelësi është në bashkëpunimin me shqiptarët që kanë qëllime të mira" dhe në krijimin e marrëdhënieve të partneritetit, theksoi ajo.

Pyetja 20. Kur është fjala për sigurinë e komunitetit serb në Kosovë, cilit institucioneve që merren me sigurinë keni besim më të madhe?



Ashtu si në pyetjen e mëparshme, numri më i madh i të anketuarve thonë se besojnë në Mbrojtjen Civile. Mbrojtja Civile ka gëzuar besimin e qytetarëve deri në momentin kur u arrit marrëveshja e shpërbërjes së saj. Ai ishte i respektuar si një institucion i cili ka mbrojtur qytetarët gjatë situatave të krizës dhe fatkeqësive natyrore, të tilla si zjarret, përmbytjet, orteqet dhe të cilat çojnë palët e kërkimit në rastet e të zhdukur apo u mbytën persona. Përsa i përket institucioneve ndërkombëtare, edhe pse të anketuarit të vetëdijshëm për rëndësinë e pranisë së tyre në Kosovë, si një aktor të




sigurisë, pjesëmarrësve të grupeve të interesit më së shumeti pengon se serbët "nuk prete për asgjë dhe se ata veprojnë vetëm ashtu si thonë të tjerët..". Të anketuarit gjithëashtu mendojnë se forcat ndërkombëtare nuk veprojnë në mënyrë konsekuente, por ata në terren zbatojnë politikën kallkuluese. Si njëri nga pjesëmarrësve të grupeve të fokusuar: "Nëse atyre i shkon për shtati atëherë ata do bëjnë lëshime Serbëve dhe do bëjnë presion ndaj shqipëtarëve dhe anasjelltas." Si problem kryesor për funksionimin e strukturave ekzistuese, dmth. të shërbimit që do të duhej të kujdeset për sigurinë në Kosovë pjesëmarrësve shohim në vullnetin politik. Shumica konsideron se niveli politik frenon dhe destabilizon aspektin e sigurisë.

Përfaqësuesi i EULEX-it në një intervistë citon shembullin e integritit të policisë që është pozitive, pavarësisht nga rezistenca fillestare drejt integritit. "Kur imazhi i policisë është i keq, atëherë tërë sistemi i sigurisë rrezikohet dhe nuk mund të funksionojë, për këtë arsye pas integritit është e rëndësishme të punohet në krijimin e imazhit të SHPK-së." Më shumë se 287² policë u integruan pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit. Gjithashtu, veçanërisht është e rëndësishme që është arrit një shkallë e bashkëpunimit më të mirë në mes të policisë në veri dhe në jug, dhe në trajnimin e tyre të përbashkët.

Sipas fjalëve të Veroljub Petronic, magjistrin për Siguri, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit, të gjitha përgjegjësit për situatën e sigurisë në Kosovë janë të vendosura ligjërisht në strukturat e sigurisë së Kosovës.

Pyetja 21. Çfarë, Sipas mendimit tuaj, cilat janë rreziqet më të mëdha të sigurisë në mjedisin tuaj?



² Qeveria e Republikës së Serbisë, Zyrës për Kosovë: "Raporti i Progresit për dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës", Prill 2015, fq. 7. Mund të gjendet në: <http://www.kim.gov.rs/doc/Finalni%20Izvestaj%20KKiM%20april%202015%20engl.pdf>




Kur është fjala për incidentet ndëretnike, mund të shohim se në Mitrovicën verore 54% e të intervistuarve pohojnë se incidentet ndëretnike janë sfidat më të mëdhaja për paqen, në Zubin Potok dhe Zvečan rreth 40% e të anketuarve, ndërsa në Leposaviq përqindje është 32.3% e të anketuarve. Duke pasur parasysh se studimi është kryer gjatë periudhës së tensioneve të ngritura dhe incidenteve ndëretnike në urën mbi Ibër, ky qëndrim e të anketuarve nga Mitrovica veriore nuk është e habitshme.

Një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve në grupet e fokusuarai rrezikun më të madh të sigurisë e shohin tek strukturat kriminale, veçanërisht në krimin e organizuar, i cili në 15 vitet e fundit lulëzoi në veri për shkak të statusit të paqartë ligjor dhe politik.

Rada Trajković në një intervistë theksoi se në kohët e fundit ne kemi një ndikim shumë të "fortë të faktorit islamik" në Kosovë e cila mund të jetë një "rrezik i madh jo vetëm për serbët, por edhe një rrezik për konflikt ndër-shqiptar", sepse duhet të kemi para sysh se Kosovë ka shqiptarë të cilët nuk mendojnë në këtë mënyrë dhe që janë të lodhur nga lufta dhe destabilizimi dhe preferojnë për të shkuar në rrugën e përparimit".

Për atë se çfarë lloji të kërcënimeve paraqesin raportet më të shpeshta për aktivitetet e ISIS në rajon dhe në territorin e Kosovës, biseduam me Veroljub PETRONIĆ. Sipas tij, grupet terroriste operojnë me tre objektiva: eliminimin fizik, dëbimin e popullatës dhe inkuadrimin e Kosovës në krizën konfliktuese që do përhapej në të gjithë rajonin dhe, rrjedhimisht, të shkaktoj shkatërrimin e institucioneve ekzistuese dhe ndryshimin e strukturës së popullsisë së Kosovës.

Pyetja 22. Si e shikoni Parkun e paqës?






Të anketuarit më të rinj në grup moshën prej 18 deri 29 vjet më së pakti besojnë se Parku i Paqes do të përmirësoi sigurinë e qytetarëve në veri (23.8%), ndërsa pritet më të larta nga Parku i Paqes kanë më të vjetër se 66 vjeçë (39.2%). Duke marrë parasysh vendin e banimit, mund të vërrejmë se të anketuarit nga të gjitha katër komunat japin përgjigje shumë të ngjashme lidhur me këtë pyetje.

Në grupet e fokusura, të anketuarit u pyetën: " Sipas mendimit tuaj çfar paraqet Parku i Paqes"? Bazuar në qëndrimet e shumicës nga grupet e fokusuarat, Parku i Paqes për serbët është një simbol i rezistencës dhe një lloj të pavarësisë, ndërsa për shqiptarët është një provokim dhe një pengesë për rrumbullakësimin e pavarësisë. Një pjesëmarrës tjetër Parkun e Paqes quajti "barrikadë moderne."

Lidhur me pyetjen për lagimin e Parkut të Paqes, një përfaqësues i EULEX-it, konsideron se nuk mund të jipet lehtë përgjigje, sepse është e nevojshme për të bërë një analizë serioze lidhur me atë se çfar ndikimin mund të ketë largimit të Parkut të Paqes për situatën e sigurisë. Rreth largimit të Parkut të Paqes nuk ka përgjegje të qartë, sepse në Kosovë vdiqet për shkak të simbolit. "Presioni për të hequr Parkun e Paqes vjen nga rrethi i ngushtë të elitës politike në Prishtinë, nga njerëzit që janë përgjegjës për integrimin. Nëse ju jeni Kryeministrin, në sytë e votuesve, dukeni keq në qoftë se nuk mund të integriresh vëry, sepse ajo është punë e juaj. Në anën tjetër, shumicës së qytetarëve të Mitrovicës së Jugut, kjo nuk intereson, ata janë të interesuar për punë biznes, shërbime komunale, Gazivodën, Trepçën, "thot përfaqësues i EULEX-it.

Pyetja 23. Si ndiheni pas integrit të pjesëtarëve të MPB-së të Serbisë në SHPK?






Kur ne shikojmë distribuimin e përgjigjeve sipas komunave të banimit, ne mund të shohim se të intervistuarit nga Zveçani thonë se ndihen disi më të sigurt se banorët e komunave të tjera (32.9%), të anketuarit nga Leposaviqi (26.2%), Mitrovica e Veriut (23.3%) dhe së fundi, të anketuarit nga Zubin Potoku (19.5%) që së paku ndjehen të sigurt pas integritit të pjesëmarrësve të MUP-it serbe në SHPK-së .

Në grupet e fokusuara, shumica e pjesëmarrësve thanë se integrimi përfundoi relativisht qetë dhe në mënyrë spontane. Pjesëmarrësit u shprehën se institucionet e SHPK-së ashtu siç janë në këtë moment nuk mund të përmirësojnë situatën e sigurisë në terren, duke vënë në dukje se është e nevojshme aftësimi i mëtejshëm i kadri policor. Në pyetjen për rolin e komandantit rajonal për veriun, shumica e pjesëmarrësve u pajtuan me faktin se ai do të jetë vetëm një figurë i cili duhet të bindet urdhrave politike të Prishtinës. Mirëpo, në pyetjen e moderatorit se kush është aktualisht një komandant rajonal për veriun, shumica e pjesëmarrësve nuk e dinin përgjigjen.

Për integrimin e pjesëtarëve të MUP-it biseduam me një oficer të integruar tashmë në SHPK-së i cili kishte përvojë të drejtpërdrejtë. Ai tha se SHPK-ja ashtu siç ekziston tani, nuk është në gjendje për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve dhe të kontribuojë në normalizimit. Arsyet janë të shumta: stafi paaftë dhe e korruptuar, dokumentet e panevojshme dhe të komplikuar, pajisjet joadekuate teknike, anëtarë indolent të shërbimit, zinxhir komandues i komplikuar, marrëdhëniet të dobëta ndërpersonale dhe të ngjashme. Ai gjithashtu tregon për dështimet në procesin e integritit, të cilat, sipas mendimit të tij, qenë të paefektshme sidomos në integrimin e policë në funksione reja, ku policët të cilët kishin përvojë në hetime ishin caktuar në policinë e trafikut, kurse policët e trafikut me përvojë janë shndërruar në nëpunës administrator ose në patrullat e rrugës. Përveç incidenteve ndëretnike, kërcënimet e sigurisë shihen edhe në paraqitjen e grupeve radikale të islamiyimit dhe grupeve kriminale që janë forcuar aq shumë sa që kërcënojnë dhe cenojnë edhe aparatit shtetëror.



Pyetja 24. Si ndiheni pas marrëveshjes për integrimin e pjesëtarëve të Mbrojtjes Civile në institucionet e Kosovës?




Të anketuarit nga të gjitha katër komunat kanë pasur vlerësime shumë të ngjashme. E njëjta gjë vlen edhe për grupmoshat dhe nivelet arsimore. Në çështjet e mëparshme ne mund të shohim se Mbrojtja Civile të të gjitha strukturave të sigurisë janë më të besuar dhe që të anketuarit janë më të kënaqur me punën e tyre (edhe pse në momentin kur u zhvillua hulumtimi shpërbërja e kësaj organizate u bë i pashmangshëm). Ndërsa shumica e qytetarëve ndjehen relativisht të sigurt pas integritit të policëve në SHPK, situata është e kundërt, kur është fjala për integrimin e pjesëtarëve të Mbrojtjes Civile.

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusuar kanë pasur komente të ngjashëm mbi punën e Mbrojtjes Civile, edhe pse me rezervë të caktuara, folën pozitivisht. Disa pjesëmarrës vurën në dukje se autoritetet në Prishtinë Mbrojtje Civile perceptohet si formacion parashtarak dhe jo-institucionale. Një numër i pjesëmarrësve vuri në dukje se një interpretim i tillë nuk është në përputhje me faktet duke pasur parasysh përgjegjësitë që ka Mbrojtja Civile.

Në pyetjen se sa është reale dhe e mundur formimi i Ushtrisë së Kosovës, Veroljub Petronić pretendon se një skenar i tillë është mjaft e mundshme, dhe gjithashtu shtoi se kjo strukturë nuk paraqet një kërcënim serioz për sigurinë e serbëve. Ai është i bindur se veprimet hetimore që do të bëjnë kundër serbëve pjesëtarët e të SHPK-së dhe strukturat ende të pa çformuara të UÇK-së janë kërcënim shumë më serioze për sigurinë e serbëve.




Pyetja 25. Shikuar në përgjithësi, deklaratat e politikanëve si ndikojnë në situatën e sigurisë në Kosovë?



Të anketuarit në grupet e fokusuara besojnë se në masë të madhe deklaratat e politikanëve në momente të ndjeshme mund të çojë në rritje të pasigurisë së përgjithshme. Prandaj, përgjegjësia e politikanëve është rritur në këto situata dhe është e nevojshme që të përmbahen nga të folurit nxitëse që mund të çojnë në mobilizimin e qytetarëve në drejtim të padëshirueshme. Në grupet e fokusuara, qytetarët kanë theksuar veçanërisht rolin negativ që në këtë proces kanë përfaqësuesit e Lëvizjes "Vetëvendosje" të cilët me retorikën e tyre provokuese nuk kontribuojnë në rritjen e stabilitetit dhe mirëkuptimin në mes të qytetarëve të nacionalitetit shqiptarë dhe serb. Pozitivisht është vlersuar komunikimi i përditshëm i kryetarëve të Veriore dhe Jugore të Mitrovicës të cilët me bashkëpunimin e tyre po kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit të brishtë pas incidenteve sporadike

Pyetja 26. Bashkëpunimi mes kryetarit të Komunës së Mitrovicës jugore dhe veriore a mund të ndihmojë në përmirësimin e sigurisë?






Bashkëbiseduesi ynë nga EULEX-i, thekson se ngjarjet e fundit (sulm me thikë ndaj një te riu serbë dhe mbytja e një shqiptari) dhe incidentet në urën mbi lumin Ibër lehtë mund të rrezikojnë situatën e brishtë të sigurisë në Mitrovicë në qoftë se nuk reagohet në mënyrë të drejtë. Ai thekson se në këto raste bashkëpunimi i kryetarëve të komunës ka qenë me rëndësi të madhe për të qetësuar situatën. Është harxhuar mjaft energji për vërtetimin e fakteve në hetimet e këtyre ngjarjeve, si dhe në bashkëpunim me komisaritet e policisë në veri dhe në jug. "Nuk dihet kurrë si një shkëndijë mund të shkaktojë shpërthim", thotë burimi ynë, duke shtuar se bashkëpunimi mes kryetarit të komunës së veriut dhe jugut është vendimtare për përmirësimin e sigurisë.




Pikëpamjet e qytetarëve mbi gjendjen e lirive dhe të drejtave në Kosovë

Pyetja 27. Në shkallë nga një deri në pesë, vlerësoni shkallën në ç'masë Marrëveshja e Brukselit ka përmirësuar liritë dhe të drejtat e komunitetit serb në Kosovë?



Pjesëmarrësit në grupet e fokusuara theksuan se gjendja nuk ishte përmirësuar pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit. E vetmja gjë që kam vënë re është se është rritur prania e policëve, por megjithatë nuk është ndryshuar situatën e përgjithshme e të drejtave të komunitetit serb, sepse të drejtat dhe liritë e tyre vazhdojnë të shkelen dhe të kufizohen. Si një ndryshim pozitiv pjesëmarrësit përmendin rritjen e sigurisë në komunikacion. Megjithatë, përveç në trafik, pjesëmarrësit theksojnë se ata nuk ndjehen të sigurt në sfera të tjera të jetës. Pjesëmarrësit përmendën disa shembuj nga përvoja personale duke theksuar se serbët vazhdojnë të sulmohen në tërë Kosovën ku ende ka incidente me motive etnike.

Pyetja 28. Cili është qëndrimi juaj ndaj rolit të gjykatës themelore e cila do të themelohet në Mitrovicën veriore?





Pyetja 29. Vlerësoni respektimin e të drejtave dhe lirive të komunitetit serb në komunat veriore?

Ne shkallen nga 1 deri ne 5

E drejta e lirisë së fesë	4.17
E drejta për gjuhën	4.03
E drejta për gjuhën arsim	3.99
E drejta për kujdesin shëndetësor	3.79
E drejta e lirisë së shprehjes	3.63
E drejta për lëvizje të lirë	3.39
E drejta për punësim	2.49

Rezultati mesatar që të anketuarit perceptojnë respektimin e përgjithshëm të të drejtave dhe lirive të serbëve në Kosovë është 3.6. Ndërsa në pothuajse të gjitha kategoritë e të drejtave dhe lirive të komunitetit serb më së miri është vlerësuar në mesin e të anketuarve nga Mitrovica veriore, dhe më së keqi në mesin e të anketuarve në Zubin Potok. Deri më tani, qytetarët në veri janë të kënaqur në përgjithësi me respektimin e të drejtave të tyre, por këtë konstatim nuk e vejnë në lidhje me institucioneve sapo të krijuara, por mbi të gjitha me nivelin e integritimit me Beogradin, konkludohet nga grupet e fokusuar.

Pjesëmarrësit në grupeve të fokusuar theksojnë se niveli i respektimit të të drejtave të njeriut është drejtpërdrejt e varur nga vullneti i politikanëve dhe strukturave politike. Një pjesëmarrës i grupit të fokusuar tha: "Aktualisht ne kemi të drejta sa i duhen politikanëve. Pra, në qoftë se duhet të keni të drejtën e votës, për të përmbushur një formë të pjesëmarrjes, ne do të kemi atë të drejtë, jashtë të drejtave të votës që të dëgjohet vullneti i përfaqësuesit e serb dhe problemet e tyre dhe ndoshta të zgjidhen problemet e tyre, kjo konkretisht nuk ekziston".

Edhe pse asnjë pjesëmarrës nuk e përmendi drejtpërdrejt rolin e bashkësisë ndërkombëtare në sigurimin e kushteve për respektimin e të drejtave të njeriut, megjithatë, disa pjesëmarrësit u pajtuan se me tërheqjen e misionëve ndërkombëtare nga Kosova, serbët do të fillojnë të largohen, sepse atëherë do të përkeqësohen të deklarojë drejtat dhe liritë e komunitetit serb. "Nga momenti që komuniteti ndërkombëtar të rhiqet nga Kosova, unë pres, nëse asgjë nuk




ndryshon, se serbët ngadalë do të fillojnë të largohen nga Kosova, sepse nuk do të jenë në gjendje për të përballuar stresin psikologjik, që do të përjeton nga çdo autoritetet në Prishtinë", thotë një pjesëmarrës i grupit të fokusuar.. Megjithatë, një pjesëmarrësit thotë se një pjesë e mirë e përgjegjësish për pozitën e keqe të serbëve mbart vetë komunitetit serb, reagimet e të cilit për shkeljen e të drejtave dhe lirive nga autoritetet, janë të buta ose plotësisht mungon. Megjithatë, një nga të intervistuarit thanë se edhe pse veriu tani është "anestizuar", prap se prap ekziston ndonjë shkëndijë për të luftuar që rrjedh nga fakti se serbët në veri, megjithatë tregojnë gatshëmëri për të krijuar politikat e tyre dhe organizuar jetën e tyre.

Shumica e pjesëmarrësve në grupet e fokusuara u pajtuan që institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për gjendjen e dobët të sigurisë dhe të shkeljeve të të drejtave dhe lirive, e cila sipas tyre shkaktohet nga joefikasiteti dhe mungesa e profesionalizmit të policisë dhe mosgjdhjës së sulmeve të motivuara etnikisht. E drejta e përdorimit të gjuhës amtare është një tjetër e drejtë që Prishtina, sipas pjesëmarrësve të grupeve të fokusuara, gjerësisht shkelin këto të drejta që përfshin: mungesën e plotë ose përkthimin joadekuat të dokumenteve zyrtare dhe të faqeve të internetit, pastaj edhe reagimet jo me kohë për ankesat të paraqitura komisionerit për gjuhët, por edhe ndjenja e përgjithshme frike e disa pjesëmarrës kur ata flasin serbisht në jug të Ibrit.

Kur është fjala për të drejtat që shkelin institucionet serbe, pjesëmarrës në radhë të parë theksojnë: pasaporta e këshillit të koordinimit, i cili është ende nën detyrimin e lëshimit të vizave dhe zhvendosjen e qendrës administrative për lëshimin e kartave të identitetit në Rashkë, kurse të pasaportëve në Beograd. Një trajtim i tillë nga ana e Serbisë e bënë që serbët nga Kosova të ndihen të izoluar dhe si "qytetarë të rendit të dytë". Një pjesë e fajit për përkeqësimin e situatës së komunitetit serb, pjesëmarrësit e grupeve të e shohin te vetë qytetarët dhe nxjerrinë në pah mungesën e interesimit dhe mungesën e informacionit.

Pyetja 30. Sa shpesh ju shkoni në mjedise ku komuniteti shqiptarë është shumicë?






Në zonat ku shqiptarët janë shumicë më shpesh shkojnë të anketuarit nga Mitrovica veriore, kurse më radhë shkojnë të anketuarit nga comun e Leposaviqit. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara si arsye kryesore pse ata nuk shkojnë më shpesh në zonat ku shqiptarët janë shumicë theksojnë pasigurinë dhe shqetësimin për sigurinë e tyre. Pjesëmarrësit deklaruan se në Prishtinë janë të detyruar të shkojnë me taksì, sepse ata kanë guxim të përdorin transportin publik.

Për pyetjet në lidhje me perceptimet e sigurisë së qytetarëve dhe lirisë së lëvizjes, përfaqësues i EULEX-it thotë se, qytetarët vetëm në veri kanë lirinë për të lëvizur normalisht. Megjithatë, nga ana tjetër, qytetarët nuk ndjehen të lirë për të udhëtuar në pjesën jugore, për arsya historike që kanë të bëjnë me natyrën e konfliktit, dhe frika. Për pretendimin e tij, personi i EULEX-it citon shembuj të punëtorëve vendas të EULEX-it, nacionalitetit serb, të cilët janë të frikësuar për të shkuar në jug, dhe konsiderojnë se është thellë e rrënjosur frika e të dy komuniteteve." "Pasiguria është e lidhur me mungesën e informative aktuale dhe me kohë si dhe me besimin e thellë për çfar duhet bërë më shumë për të ndryshuar këtë situatë." Një problem i madh është se "frika e panjohur krijon urrejtjen që të shpien në pamundësin dhe rezistencën ndaj çfardo lloji të bashkëpunimit nga të dy palët". Sektorin civil ai e sheh si një element veçanërisht të rëndësishme në procesin e pajtimit që mund të kontribuoi shumë në zbulimin e hapësirave për dialog dhe projekte të përbashkëta.

Pyetja 31. A e shihni veten në pesë vitet e ardhshme në Kosovë?





Të anketuarit nga të katër komuna janë përgjigjur në mënyrë të ngjashme. Në anën tjetër, kur shikojmë grup moshat mund të shohim se një numër i madh i të anketuarve të rinj (40%) të moshës 18 deri 29 thojnë se në të ardhmen ata nuk e shohin veten në Kosovë. Të dhëna të ngjashme janë marrë edhe për popullatën me arsim të lartë, ku çdo i treti anketuar i diplomuar në Fakultet planifikon të largohet nga Kosova. Mendimi për largimin nga Kosova është më i theksuar në mesin e studentëve të papunë.

Pjesëmarrësit në grupet e fokusuara besojnë se serbët janë në një pozitë të vështirë dhe të dëshpëruar pa perspektivë dhe se te ata dominon një ndjenjë e pasigurisë dhe frikës. Dalja nga kjo situatë pjesëmarrësit shohin në luftën për një pozitë më të mirë socio-ekonomike të serbëve në veri të Kosovës, çrrënjosjen e korrupsionit dhe nepotizmit, investimet në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, forcimin e institucioneve demokratike dhe një përdorim më të përshtatshëm dhe kuptimplotë të fondeve që vijnë nga buxheti i Kosovës.



Konkudimet

- Dy vjet pas nënshkrimit të marrëveshjes së parë mbi parimet e normalizimit të marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës, për serbët në veri të Kosovës pak gjëra rrënjësisht janë ndryshuar për të mirë, klështu që qytetarët atje mendojnë se gjendja e tyre është përkeqësuar dhe janë më afër afër pozitës së serbëve të cilët janë të vendosur në jug të Ibrit. Në anën tjetër, sukcesi i marrëveshjeve është vënë në pikëpyetje pasi që normalizimi i marrëdhënieve mes dy qeverive nuk çoi deri te normalizimi i marrëdhënieve në terren, në mënyrë rezultateve e hulumtimeve parashtrajnë pyetjen: "Kush do të mbetet për të jetuar me Marrëveshjen e Brukselit?", kur më shumë se 40 % e të rinjve serbë, në të ardhmen nuk e shehin veten në Kosovë. Në mënyrë të ngjashme, 60.5% e të anketuarve nga veriu asnjëherë ose rrallë hyn në ambiente në të cilën jetojnë shqiptarët. Këto rezultate tregojnë se distanca etnike që është krijuar mes serbëve dhe shqiptarëve nuk bien, pavarësisht nga marrëveshjet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës
- Mos rregullimi ligjor është një nga faktorët kryesorë që komplikon jetën dhe aktivitetet e përditshme. Më së shumti probleme shkaktojnë dokumentet e "pavlefshme": dokumentet personale, patentë shoferi, regjistrimi, diplomat; pastaj pamundësia e vërtetimit të kontratave, ekstrakte kadastrale, mosnjohja e kunorizimeve martesore pas vitit 1999.
- Megjithëse niveli i besimit, si dhe kënaqësia e përgjithëshme me rezultatet e punës së institucioneve të bashkësisë ndërkombëtare është shumë e ulët, serbët janë ende të friksuar nga pasojat e tërheqjes së bashkësisë ndërkombëtare nga Kosova, sepse mendojnë se pasojat e një zhvillimi të tillë mund të shkaktoi largimin e tyre masovikisht. Ky rezultat tregon se institucionet ndërkombëtare që serbët kryesisht e fajësojnë për gjendjen e keqe të sigurisë, prapëseprap në të njëjtën kohë ata i shohin si të vetmin garantues për situatën e qëndrueshme ..
- Të anketuarit pajtohen me faktin se burimi kryesor i të ardhurave të qytetarëve në veri është buxheti të Republikës së Serbisë. Numri më i madh i njerëzve marrin një formë të ardhurave nga Republika e Serbisë (në bazë të rezultateve tona, 52.2%), megjithatë, një pjesë e mirë e të anketuarve deklaruan se gjendja e tillë ofron vetëm gjoja një sistem të qëndrueshëm shoqëror. Kur është fjala për tejkalimin e kësaj situate, nuk ka konsensus: disa pjesëmarrës konsiderojnë se zgjidhja qëndron në krijimin e reparteve të prodhimit me kapacitete të larta, në të cilat do të



punësoheshin një numër më i madh të punëtorëve, ndërsa të tjerë besojnë se çelësi qëndron te bizneset e vogla familjare, të cilat janë më fleksibël dhe më rezistent ndaj krizës.

- Pavarësisht prej pakënaqësisë me përfaqësuesit politikë, serbët nga veriu, megjithatë, gjithnjë e më shumë (56.3%) mbështesin pjesëmarrjen në institucionet e Kosovës, por vazhdueshme theksojnë që ajo duhet të bëhet në një mënyrë shumë më konstruktive dhe efikase.
- Në Asociacioni e komunave serbe në përgjithësi trajtohet si një mekanizëm që është projektuar për të mbrojtur të drejtat e komunitetit serb dhe si një nga rezultatet pozitive të Marrëveshjes së Brukselit, dhe përveç kësaj, të anketuarit nuk kanë shpresa të mëdha edhe atëherë kur është fjala për kompetencat dhe për datën e themelimit të saj .



Falënderim

Për realizimin e këtij hulumtimi, ne jemi veçanërisht mirënjohës për qytetarët të cilët kanë pranuar të marrin pjesë në hulumtime, por edhe të gjithë anëtarët e Platformës për Analiza dhe hulumtime të cilët zbatuan hulumtimin:

- **Moderatorëve të grupeve të fokusuara:** Dušan Milunovići, Lazar Aksić, Stevan Đokić, Milica Andrić, Dragan Aleksić, Ivan Božović, Miloš Timotijević dhe Ivani Vukašinović.
- **Të intervistuarëve:** Branislav Nešović, Lazar Rakić, Dušan Milunović, Lazar Milić, Milica Andrić, Jelena Vićentijević dhe Igor Dašić.
- **Moderatorëve të truezës së rrumbullakët:** Lazar Rakić, Luka Raduloviću, Dejan Mirić, Aleksandar Zdravković, Marko Marjanović i Darko Stanković.
- **Anketarëve:** Milica Rakić, Miljana Stanišić, Dušan Milunović, Luka Radulović, Milica Andrić, Lazar Rakić, Igor Dašić, Haris Čekić, Dejan Mirić, Aleksandar Zdravković, Ivan Vukašinović, Lazar Aksić, Miloš Timotijević, Lazar Milić, Darko Stanković, Tijana Ilić, Jelena Perović, Marko Ćirković, Mirjana Đurić, Marko Marjanović, Milija Biševac, Ivan Božović, Marko Rakić, Dragan Aleksić, Svetlana Đurić, Stevan Đokić dhe Nikola Bošković
- **Koordinatorëve për sistematizimin e të dhënave :** Lidija Kuljač, Katarina Bakalić, Milica Stanković, Aleksandra Klarić dhe Veljko Jovanović.